



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe**  
**Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil (OKiia)**

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS**

**I. HYRJE**

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për OKiia. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimitarisë së OKiia në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës OKiia ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. OKiia do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës së OKiia, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.okiia.gov.al](http://www.okiia.gov.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë lehtësisht i aksesueshem për publikun në faqen e OKiia: [www.okiia.gov.al](http://www.okiia.gov.al).

**II. PARIME TË PËRGJITHSHME**

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AP -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: OKiia ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e OKIIA dhe përkatësisht: **Ligj 10040, dt.22.12.2008**, i ndryshuar me **Ligj 10484 dt.24.11.201** si edhe VKM dhe rregulloret e ndryshme për OKIIA (në faqen e OKIIA është e publikuar e gjithë baza ligjore).
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë, i saktë dhe i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

### III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, OKIIA vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit [www.okiia.gov.al](http://www.okiia.gov.al) kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik (**sipas VKM 686 dt.02-06-2010**);
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë (<http://www.okiia.gov.al/baza.html>);
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; (OKIIA nuk jep informacion për publikun gjatë kohës që kryhen investigimet për ngjarjet në aviacion civil apo për veprimtarinë rutinë të institucionit; raportet bëhen publike sipas afateve përkatëse dhe me miratimin e Ministrit të MTI; publikimi i tyre bëhet në faqen [www.okiia.gov.al/p.html](http://www.okiia.gov.al/p.html)).
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit (shiko në <http://www.okiia.gov.al/index.html>);
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

	2012			2013			2014		
	plan	fakt	ne %	plan	fakt	ne %	plan	fakt	ne %
231	3,000	2,756	92%	1,000	0	0%	2,500	154	6%
600	8,140	6,276	77%	8,250	6,352	77%	8,200	6,150	75%
601	1,400	974	70%	1,470	1,014	69%	1,490	1,002	67%
602	9,000	5,424	60%	9,000	1,457	16%	9,000	2,460	27%

	2015			2016			2017		
	plan	fakt	ne %	plan	fakt	ne %	plan	fakt	ne %
231	5,000	3,660	73%	2,500	2,156	86%	2,000	1,306	65%
600	8,200	5,311	65%	6,800	5,868	86%	7,500	6,872	92%
601	1,490	862	58%	1,400	955	68%	1,400	1,028	73%
602	9,000	2,551	28%	7,000	3,443	49%	5,000	3,788	76%

\*) të dhënat janë në mijë lekë

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme (rregjistri i prokurimeve).
- **Theksojme se OKIIA nuk kryhen drejtpërdrejt shërbime për publikun, veprimtaria e OKIIA kufizohet në investigimin e incidenteve të rënda dhe aksidenteve ajrore, mundësisht në gjetjen e shkaqeve pa përcaktuar përgjegjësi penale si dhe në rekomandimet për eliminimin e tyre në të ardhmen; OKIIA mund të kryejë kryesisht edhe investigime në lidhje me parrezekshmërinë në fluturim brenda kornizës ligjore dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në parlament.**
- **OKIIA nuk nxjerr akte/norma/kufizime në lidhje me të drejtat themelore të njeriut.**

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

#### IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË OKIIA

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesën	Baza ligjore	Dokumenti / Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacion Civil është krijuar në Qershor 2010. Është përgjegjës për investigimet e incidenteve/aksidenteve ajrore brenda hapësirës ajrore të Republikës së	Neni 7/1/a/d	<a href="http://okii.gov.al/baza.html">http://okii.gov.al/baza.html</a>	Menjehere sapo te krijohet website dhe duke bere	Ne faqen zyrtare te OKIIA okii.gov.al	OKIIA

<p>Shqipërisë. Synimi i OKIIA është të përmirësojë sigurinë në fluturim duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përcaktuar shkaqet e aksidenteve dhe incidenteve ajrore;</li> <li>2. duke bërë rekomandime sigurie që kanë për qëllim të parandalojnë ngjarje të njëjta në të ardhmen.</li> </ol> <p>Qëllim i investigimeve të OKIIA nuk është të përcaktojë fajet dhe përgjegjësi.</p>			<p><i>perditesimet e duhura</i></p>		
<p><b>Baza Ligjore:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kodin Ajor të RSH, miratuar me <b>Ligj 10040, dt.22.12.2008</b>, i ndryshuar me <b>Ligj 10484 dt.24.11.2011</b>;</li> <li>2. ICAO Annex 13, Aircraft Accident and Incident Investigation;</li> <li>3. Rregulloren e BE Nr.996/2010 të Parlamentit Europian si dhe Direktivën 94/56/EC dt.20.10.2010 të KE mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil;</li> <li>4. VKM 686, dt.02.06.2010;</li> <li>5. Urdhër i Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit nr. 68, dt.10.06.2011: "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR RAPORTIMIN E NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL"</li> <li>6. Urdhër i Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit nr.123, dt.22.12.2011: "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR INTEGRIMIN NË NJË CENTRAL INFO DB PËR NGJARJET NË AC DHE SHPËRNDARJA TE PALET E INTERESUARA"</li> </ol>	<p>Neni 7/1/b</p>	<p><a href="http://okii.gov.al/baza.html">http://okii.gov.al/baza.html</a></p>	<p><i>Menjehere sapo te krijohet website dhe duke bere perditesimet e duhura ne vazhdimesi.</i></p>	<p>Referenca ne faqen e OKIIA: <a href="http://okii.gov.al">okii.gov.al</a>; (ligjet, VKM,etj gjenden ne <a href="http://www.ligjet.org">www.ligjet.org</a>)</p>	<p>OKIIA</p>
<p>Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.</p>	<p>Neni 7/1/c/g</p>	<p><a href="http://okii.gov.al/programi_tranparences">http://okii.gov.al/programi_tranparences</a></p>	<p><i>Menjehere sapo te krijohet website dhe duke bere perditesimet e duhura ne vazhdimesi.</i></p>	<p>Ne faqen web te OKIIA: <a href="http://okii.gov.al">okii.gov.al</a></p>	

OKIIA Rruga Princ Vidi, Tiranë, Shqipëri P.O.Box 74	Neni7/ 1/ç	<a href="http://okiia.gov.al">http://okiia.gov.al</a>			
Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumenta te tjere;	Neni7/ 1/ dh	Raportet e auditit; raportet periodike te OKIIA			
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Prokurimet sipas publikimeve ne faqen e APP			
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i				

## V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, OKIIA vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit [www.okiia.gov.al](http://www.okiia.gov.al), kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.